



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 07.02.2025

Nr: 67

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË ZYRËS VENDORE
ARSIMORE PEQIN, PËR PERIUdhËN 26 JANAR-01 SHKURT 2025

Sot, më datë 07.02.2025 unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me

SUBJEKT: Zyra Vendore Arsimore Peqin

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Zyrës Vendore Arsimore Peqin për periudhën 26 janar deri më 01 shkurt 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 26 janar-01 shkurt 2025, Zyra Vendore Arsimore Peqin ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Drejtësi “U zhvillua një takim informues me gjimnazistët e gjimnazit "Zihni Magani" Peqin, lidhur me pushtetin legjislativ, funksionet e tij, sa transparent është”, raportuar në datën 28.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 28.1.2025.

Nëpërmjet email-it, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Zyrës Vendore Arsimore Peqin një informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes.

Data: 07.02.2025 Nr: 67
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Zyrës Vendore Arsimore Peqin, për periudhën 26 janar – 01 shkurt 2025”

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Zyrës Vendore Arsimore Peqin ka dërguar pretendimet, duke sqaruar se: *“Zyra Vendore Arsimore Peqin ka bërë raportimin në ndërfaqen e KQZ-së më datë 28.1.2025, për një veprimtari të zhvilluar më datë 28.1.2025, veprimtari, e cila, është raportuar gabimisht nga institucioni jonë pasi qëllimi i raportimit ka qenë deklarimi dhe transparenca e veprimtarisë së zhvilluar, pasi kjo veprimtari është organizuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, lloji i veprimtarisë “Informim /ndërgjegjësim” me tematikë “prezantimin e programeve edukuese të Kuvendit nga shërbimi i edukimit qytetar si dhe sesione informuese mbi rolin dhe organizimin e veprimtarisë parlamentare në Kuvendin e Shqipërisë”. Kjo veprimtari e zhvilluar nga Kuvendi i Shqipërisë është raportuar në ndërfaqen e KQZ me datë 22.1.2025, ora 14:13, nga Institucioni i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ndërsa veprimtaria u zhvillua më datë 28.1.2025 brenda afatit 5 ditor të zhvillimit të veprimtarisë.*

Pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, konstatova se Zyra Vendore Arsimore Peqin nuk ka patur mundësi të raportojë në kohë për këto aktivitete për shkak se ka qenë në cilësinë e të ftuarit.

Për sa më sipër, referuar pikës 3, të nenit 5, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, i ndryshuar, veprimtaritë ku institucioni publik apo përfaqësues të tij janë ftuar për të marrë pjesë, nuk mbartin detyrimin për t’u raportuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Zyrës Vendore Arsimore Peqin
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI